

LIGJ
Nr. 112/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE
TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2011 PËR PROJEKTIN
“PROGRAMI I MBROJTJES MJEDISORE TË LIQENIT TË SHKODRËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011 për projektin “Programi i mbrojtjes mjedisore të liqenit të Shkodrës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.7.2014

**Shpallur me dekreten nr. 8694, datë 22.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR 2011 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË LIQENIT
TË SHKODRËS”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë;
Në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

Duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

Të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

Me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

Duke in referuar premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 197/2011 e datës 23 nëntor 2011), si dhe shënimit për rezultatin e konsultimeve mbi bashkëpunimin zhvillimor të datës 5 nëntor 2013;

ranë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e mëposhtme:

- një shumë financimi me vlerë prej gjithsej 3 000 000 eurosh (me fjalë: tre milionë euro) për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të Liqenit të Shkodrës”,

kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur dhe kur është konfirmuar se ai plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale ose një fond garantues i kredive për ndërmarrje të mesme, ose një masë për luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, ose një masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të gruas.

2. Kur për projektin e përmendur në paragrafin 1 nuk mund të jepet konfirmimi për të cilin bëhet fjalë atje, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga KfW-ja për këtë projekt një hua deri në vlerën e shumës së parashikuar të financimit.

3. Po të bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Kur projekti zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale, ose një fond garantues i kredive për ndërmarrje të mesme, ose një masë për luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, ose një masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të gruas, mund të akordohet një shumë financimi, në rastin e kundërt mund të jepet një hua.

4. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga KfW-ja hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruuese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo Marrëveshje.

5. Shumat e financimit për masa shoqëruuese sipas paragrafit 1 dhe paragrafit 4, do të kthehen në hua, në qoftë se nuk do të përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis KfW-së dhe marrësve të shumave të financimit, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për financim nuk janë përfunduar brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimeve. Për këtë shumë, afati mbaron në datën 31 dhjetor 2019.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj KfW-së pretendime të mundshme lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë në kuadrin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht

ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, që rezultojnë nga dhënia e shumës së financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, në datën 22 prill 2014, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.